



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk. II.nr.892/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitia Ymeri, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të sigurimit NPSH Dekoral me seli në fshatin Gjurakoc Komuna e Istogut, të cilën e përfaqësojnë Z.F dhe A.Rr, ndaj kundërshtarit të sigurimit Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë të cilën sipas auorizimit e përfaqëson A.Z nga Avokatura Shtetore, dhe Kompania e sigurimeve Prisig me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson me autorizim A.K, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.E.K.nr.649/21 datës 11.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 02.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit të sigurimit NPSH Dekoral me seli në fshatin Gjurakoc Komuna e Istogut, dhe VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.649/21 e datës 11.01.2022.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar V.EK.nr.649/21 datës 11.01.2022, e ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit NPSH Dekoral me seli në fshatin Gjurakoc Komuna e Istogut, i paraqitur kundër kundërshtarit të dytë të sigurimit të dytë të sigurimit kompania e sigurimeve Prisig nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të ndalohej i padituri i dytë/kundërshtari i sigurimit Kompania e sigurimeve Prisig, që të bëjë ekzekutimin e garancionit në shumën prej 105,000.00€ dhe të avansit 157,482.55€ në llogarin e të paditurit të parë Ministria e Punëve të Brendshme.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i propozuesit të sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka shkelur parimin e të vërtetës materiale, me arsyetim kontradiktor, në kundërshtim me dispozitivin e aktvendimit, pastaj nuk ka shqyrtuar të gjitha provat. Mos vërtetimi i fakteve vendimtare përbën shkelje nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) të LPK-së. Gjykata njëanshëm I është referuar vetëm nenit 36 te kontratës ndërsa nuk ka pasur paarsysh nenin 38 të Kontratës dhe nuk ka pasur paarsysh që mos përmbushja e kontratës ka ardhur për shkak të rrethanave që nuk varen nga paditësi-propozuesi dhe që nuk kanë mundur të parashikohen me rastin e nënshkrimit të kontratës. Kërkojmë nga gjykata të nxjerr aktvendim me të cilin aprovohet ankesa e propozuesit të

sigurimit NPSH Dekoral nga fshati Gurrakoc Komuna e Istogut, të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.649/21 e datës 11.01.202, si dhe të ndalohet kundërshtari i dytë i sigurimit të bëj ekzekutimin e sigurimit të avansit në shumën prej 157,482.55€ dhe sigurimit të ekzekutimit në shumën prej 105,000.00€, në llogari të paditurit të parë, sipas dokumenteve garantuese dt.29.08.2018 dhe 11.09.2018.

Kundërshtarët e sigurimit nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit NPSH Dekoral nga fshati Gurrakoc Komuna e Istogut, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 05.10.2021, ka paraqit padi me propozimin e masës së sigurimit kundër të paditurave-kundërshtareve të sigurimit Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë dhe Kompania e sigurimeve Prisig me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin e masës së sigurimit, ka marrë Aktvendimin V.EK.nr.649/21 datës 11.01.2022, me të cilin e ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit NPSH Dekoral me seli në fshatin Gjurakoc Komuna e Istogut, i paraqitur kundër kundërshtarit të dytë të sigurimit të dytë të sigurimit kompania e sigurimeve Prisig nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të ndalohet i padituri i dytë/kundërshtari i sigurimit Kompania e sigurimeve Prisig, që të bëj ekzekutimin e garancionit në shumën prej 105,000.00€ dhe të avansit 157,482.55€ në llogarin e të paditurit të parë Ministria e Punëve të Brendshme. Në asyetim të këtij vendimi gjykata e shkallës së parë referohet në nenin 36 të Kontratës,, dhe se në këtë fazë të procedurës gjykata nuk ka gjetur prova të mjaftueshme për të konstatuar nëse pretendimet mbi forcën madhore janë të bazuara, e të cilat do ta bënë kërkesën e saj të besueshme.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të propozuesit se aktvendimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes nuk janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 par.1 pika (a) dhe (b), e të cilat i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive

dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të mund ti pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës, ngase propozuesi nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë bindëse me të cilën do të bënte të besueshme dhe të pranueshme propozimin për gjykatën, andaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë, si dhe nuk ka arritur të bëjë të besueshme të drejtën subjektive e as ekzistimin e rrezikut.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi që gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar vetëm rrethanat nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive, si dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do ti pamundësohej dukshëm realizimi i kërkesës, duke mos u lëshuar në shqyrtimin e rrethanave apo fakteve të tjera që lidhen me themelësinë e kërkesëpadisë, e të cilat mund ta prejudikojnë vendosjen meritore të çështjes.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II nr.892/22 datë 02.09.2022

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari
Krenar Berisha